



ANALIZA VJETORE

2009

(Efektiviteti ne pune i administrates se Bashkise për vitin 2009)

Janar 2010

Te nderuar pjesemarrës !

Objekti i kesaj analize do jete ballafaqimi me objektivat e vena ne fillim te vitit 2009, evidentimi i rezultateve te arritura dhe nxjerrja ne pah e mangesive dhe mos-realizimeve te konstatuara sipas sektoreve dhe drejtorive, te administrates se Bashkise.

Gjithashtu ne kete analize do te shpallen edhe disa nga objektivat kryesore te cilet do te jene pika referimi ne punen e administrates, per vitin buxhetor 2010.

Viti qe sapo mbyllem ka qene një vit i veçante i cili do mbetet ne kujtesen e banorëve lezhjan dhe mbarë shqiptareve, per faktin se :

- Perballuam ndikimin e nje krize ekonomike mbarëboterore, krize e cila ka patur ndikime jo te pakta edhe ne ekonomine shqiptare, perfshire edhe Bashkine e Lezhes,
- Viti 2009 si vit elektorale, krahas zgjidhjes qe dha elektorati shqiptar per kater vitet ne vijim, nuk kaloi pa ndikime edhe ne aspektin ekonomik dhe administrativ.
- Gjithashtu viti 2009 do te kujtohet nga komuniteti lezhjan sepse moren zgjidhje disa investime te rendesishme publike nder te cilat evidentojme:
 - a. Perfundimin e ujesjellesit lagje “Nene Tereza”, pavaresisht nga problematika qe u kriju ne fazen e venjes ne shfrytezim te tij.
 - b. Ndertimi i kanalizimeve te ujrave te zeza po ne kete lagje, nje investim me vlere shume te medha jo vetem financiare, por edhe per problematiken qe ai zgjidh, per banoret e kesaj lagje.
 - c. Perfundimi i rikonstruksionit te bllokut pas Hotel “Lis” lagje Beslidhja, nje nga investimet me komplekse te kryera ne qytetin tone..
 - d. Fillimin e punimeve ne dy akse rrugore ne lagje “Nene Tereza dhe “Skenderbeg” – blloku “Liria” etj.

Keto, e mjaft pune te tjera te kryera gjate vitit 2009 jane tregues pozitiv, siç eshte negative mosrealizimi i te ardhurave, i cili ka patur ndikim ne investimet e planifikuara te realizoheshim nga te ardhurat vendore.

Per te qene me konkret po evidentojme objektivat qe kemi patur per vitin 2009 :

1. Realizimin e Studimit të Përgjithshëm Urbanistik për qytetin e Lezhës;
2. Përmbyllja e fazës studimore te Parkut Industrial dhe miratimi i tij në të gjitha nivelet e qeverisjes ;
3. Përfundimi i rrugës së Spitalit;
4. Investime e përmirësime të rrjetit të brëndshëm infrastrukturorë në lagjet kryesore të qytetit;
5. Rikonstruksioni i plotë i rrugës së varrezave publike;
6. Realizimi e tejkalimi i të ardhurave të programuara e të miratuara për vitin 2009;
7. Evidentimi, inventarizimi dhe venia në eficensë i të gjitha pronave të bashkisë;
8. Ndërtimi me donator i rrugës së Kalasë;

9. Ndërtimi i ujësjellësit të lagjes Sheher;
10. Rritjen e efikasitetit e të kontrollit në punë të administratës;
11. Rritjen e efikasitetit dhe transparencës në të gjitha shpenzimet ;
12. Përmirësimin e rritjen e vazhdueshme të nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve;

Por cili ka qene realizimi i tyre per vitin 2009:

Nga 12 objektiva te planifikuara per vitin 2009, jane realizuar 8 prej tyre dhe konkretisht:

1. Eshte perfunduar faza e parë e Planit te Pergjithshem Rregullues, duke iu nenshtruar nje diskutimi masiv ne prani te specialisteve dhe banoreve te qytetit.
2. Eshte mbyllur faza studimore dhe miratimi i Parkut Industrial në të gjitha nivelet e qeverisjes;
3. Eshte punuar per permirësimin e rrjetit te brëndshëm te infrastrukturorë publike në qytet, pune e cila mbetet ne proces te përvitshem;
4. Eshte kryer rikonstruksioni i rrugës së varrezave publike, mbetet ne proces nje segment i shkurter brënda qytetit ;
5. Eshte realizuar evidentimi dhe inventarizimi i pronave te Bashkise dhe eshte pergatitur nje pjese e dokumentacionit, per hipotekimin e tyre ne ZRRPP ;
6. Eshte rritur efikasiteti i kontrollit në punën e administratës ;
7. Eshte rritur kontrolli dhe transparenca në të gjitha shpenzimet e Bashkise;
8. Eshte përmirësuar dhe rritur niveli i shërbimeve ndaj qytetarëve ;

Ndersa i bashkëngjiten objektiveve te vitit 2010 mosrealizimet si me poshte :

1. Ndertimi i rruges Spitalit. (i premtuar per financim edhe kete vit nga MPPT&T).
2. Ndertimi i rruges se Kalase. (i premtuar po nga MTKR&S).
3. Ndertimi i ujësjellësit të lagjes Sheher.
4. Realizimin ritmik te te ardhurave per vitin 2010.

Krahas objektiveve ne pergjithesi dhe mosrealizimeve te paraqitura me lart, mund t'u njohim me konkretisht ;

Si janë realizuar objektivat dhe detyrat funksionale sipas drejtorive, per vitin 2009 :

DREJTORIA E TE ARDHURAVE :

Ka patur si objektiv :

1. Realizimin e tejkalimin e të ardhurave të programuara për vitin 2009;
2. Brënda muajit mars 2009 të inspektohen të gjitha subjektet tatim-paguese
3. Brënda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2009 të bëhet e mundur që në teritorin e bashkisë Lezhë të mos kemi asnjë subjekt të palicensuar.
4. Deri në fund të vitit 2009 të përgatitet një studim i plotë mbi strategjinë e sigurimit të të ardhurave në bashkinë Lezhë për vitet 2010-2011.

Realizimi i te ardhurave per vitin 2009:

Planifikuar 186.266 mije leke , realizuar 119.460 mije leke ose **64.14 %**

Te ardhurat nga sistemi i taksave vendore:

- Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme planifikuar 9.000.000 leke , realizuar 6.788.000 leke nga oe 75.42%.
- Taksa e regjistrimit te mjeteve te transportit rrugor , planifikuar 6.800.000 leke, realizuar 4.912.000 leke ose 72.24 %.
- Te ardhurat me agjentet tatimor (Bashkin - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore) planifikuar 117.330.000 leke , realizuar 77.461.000 leke ose 66%
- Subjekte te reja regjistruar në vitin 2009, gjithësej 159 , nga te cilat 134 fizike, 25 Juridike.

Te ardhurat nga tarifat vendore

- Tarifa e pastrimit planifikuar 23.800.000 leke, realizuar 14.504.000 leke ose 60.94 %
- Perdorimi i pronave Publike planifikuar 4.000.000 leke; realizuar 1.946.000 leke ose 48.65%.
- Dhenje leje, licenca e autorizime planifikuar 2.000.000 leke, realizuar 1.899.000 leke ose 94.95 %.
- Te adhura nga Kopshtet, Çerdhe dhe Konvikti planifikuar 5.500.000 lekë, realizuar 4.613.000 lekë ose 83.87%.

Disa probleme qe kanë ndikuar ne mosrealizimin e të ardhurave janë :

- Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme eshte planifikuar te realizohet nga ZRRPP, si agjent tatimor.
Mbetet problem bashkërendimi me kete institucion.
- Taksa e regjistrimit te mjeteve te transportit rrugor , planifikuar te realizohet nga Drejtoria Rajonale e Sherbimit Transportit Laç.
Agjent tatimor me te cilin akoma nuk eshte gjetur gjuha e bashkëpunimit.
- Jane ç' regjistruar ose mbyllur perkohesisht 192 njesi biznesi , te cilat kane patur nje ndikim negativ prej 3.722.000 lekë ne te ardhurat e vitit 2009.
- Kalimi ne regjistrin pasiv te 54 bizneseve kane patur nje efekt negativ ne shumen 2.734.000 leke
- Aktualisht kemi rreth 76 njesi qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne territorin e Bashkise, por qe paguajne taksat ne komunat perreth (Kolsh, Shengjin dhe Balldre), me efekt ekonomik negativ prej 3.500.000 leke
- Gjithashtu taksa se ndikimit ne infrastrukture eshte parashikuar mbi mundesine reale te ndertuesve.
- Skonta e aplikuar për pagesa të menjëhershme te bizneseve ka patur nje ndikim prej 1.597.000 lekë .
- Theksojme se akoma nuk eshte krijuar tradita e likujdimit te tarifes se pastrimit nga abonentet familjare. Tarife e realizuar vetem 33%.

- Mosrealizimet e sipërcituara per vitin 2009 kane patur nje efekt negativ ndaj planit te te ardhurave ne shumen prej 11.553.000 lekë.
- Shtojme se debitoret e krijuar gjatë vitit 2009 kane patur nje ndikim negativ prej 3.988.000 lekë.

Ne kete menyre i mungojne buxhetit te vitit 2009 mbi 15.541.000 lekë.

Me pervojen pozitive te vitit 2009 dhe njohjen e mangesive qe sollen mosrealizimin e te ardhurave, do ndertohtet nje pune me konkrete dhe efektive nga administrata tatimore e Bashkise, per vitin 2010.

DREJTORIA E FINANCES :

Ka patur si objektiva kryesore :

1. Ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme te gjendjes financiare si : te ardhurat; shpenzimet, investimet dhe inventarizimi i pasurise, në administraten e bashkise dhe institucionet vartëse ;
2. Rritjen e efikasitetit dhe transparencës në të gjitha shpenzimet ;

Cilët janë treguesit financiare të vitit 2009 :

- Planifikuar : 334.232.179 leke; realizuar : 328.002.496 leke ose 98,13 % nga i cili :
- Fondi i pagave, planifikuar 53.957.735 leke, realizuar 52.927.630 leke ose 98 %.
- Shpenzime planifikuar 129.399.897 lekë; realizuar 125.929.552 leke ose 97,3 %.
- Investimet planifikuar 104.030.647 leke; realizuar 101.942.935 leke ose 98 %.
- Sherbime planifikuar 32.674.000 leke; realizuar 32.041.413 leke ose 98 %.

Arsyet e mosrealizimit te shpenzimeve ? :

- Eshte synuar qe niveli i shpenzimeve te mos tejkaloje mundesite e financimit me buxhetin qe kemi patur si nga Granti dhe te ardhurat.
- Eshte bërë kujdes me numrin e punonjesve, per te mos rënduar fondin e pagave.
- Ne uljen e shpenzimeve per riparime e sherbime ka ndikuar, aktivizimi maksimal i forcave te punës dhe mjetet mekanike te bashkise;

Probleme te evidentuara :

- ❖ Fondi i pagave, pas muajit korrik e ne vijim eshte i varur kryesisht nga realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore.
- ❖ Tejkalmi i shpenzimeve ne disa zera veçanerisht ne energji elektrike ka ardhur nga pamundesia e menaxhimit te konsumit nga institucionet vartëse, mungesa e matësve dhe moskontrolli i rrjetit qe furnizon institucionet dhe ndriçimin rrugor.
- ❖ Mosrealizimi i investimeve me fondet e bashkise, ka patur dy arsye kryesore :
Se pari : Mangesi ne hartimin e projekteve, sepse nje pjese e konsiderueshme e investimeve nga ta ardhurat u planifikuan nga buxhetimi ne komunitet, ndonese nuk kishim projekte te gatshme.
Se dyti : Mosrealizimi te ardhurave, planifikuar per investime publike te vitit 2009, ishte pengese serioze per realizimin e tyre.

DREJTORIA E URBANISTIKES :

Ka patur si objektiva kryesore :

1. Ndjekjen e detyrave qe i perkasin hartimit te Planit te Përgjithshëm Rregullues.
2. Evidentimi dhe inventarizimi rrugëve, shesheve, hapësirave publike, lulishteve e pronave të tjera bashkiake, duke i shoqëruar ato me materialin e duhur teknik.
3. Ndjekjen në vijimësi te punes, për hartimin e projekteve për punët perspective të zhvillimit të qytetit, duke i miratuar ato në të gjitha instancat, per t'i hapur rrugë investimeve;
4. Hartimi i një guide orientuese për parkun industrial, me qëllim që t'u vihen në dispozicion zhvilluesve të mundshëm për të tërhequr investimet e tyre.
5. Realizimi e tejkalimi i të ardhurave të programuara e të miratuara për vitin 2009;

Synimet :

Ne punen gjithëvjetrore te kesaj drejtorie eshte synuar, qe perpunimi i te dhenave te mundesoje nje Plani Rregullues cilësor i cili te permbushe kerkësat ne keto aspekte si:

- Ne intensitetin dhe tipologjine e ndertimeve duke zbatuar rregulloren e urbanistikes.
- Klasifikimin ne zona funksionale te territorit qe perfshihet nga plani, duke u mbeshtetur ne gjendjen egzistuese, ne perdorimet e mundshme, ne dendesite e banimit si dhe ne rregullat qe duhen ndjekur per te ndryshuar destinacionin e perdorimit te tyre.
- Shqyrtimin e zonave qe do ti nenshtrohen nderhyrjeve te rikonstruksionit urbanistik dhe percaktimin e zonave per shtrirjen e qytetit,
- Kufizime ne lidhje me ndertimet per:
 - a. - terriore apo zona me ndertime qe paraqesin interes historik dhe arkeologjik
 - b. - mbrojtjen e funksionit te infrastruktures dhe impianteve me interesa publik
 - c. - mbrojtjen e zonave te gjelbëruara etj.

Nder realizimet vjetore evidentojme :

- Eshte perfunduar faza e parë e Planit Rregullues te qytetit., si Detyra e Projektimit, mbledhja e te dhenave dhe diskutimi me specialist, banor dhe grupe te interesit, mbi punen e deritanishme ne sherbim te Planit Rregullues.
- Janë hartuar e miratuar ne KRRT Detyrat e Projektimit dhe Projektet per 7 (shtatë) investime publike.
- Janë përpunuar dhe hedhur ne kompjuter te dhënat per sistemin e adresave, mbetet per tu përfunduar krijimi i database-it.
- Jane realizuar kerkesat e detyrimet ndaj subjekteve private, si ne shqyrtimin e dokumentacionit teknik, per sheshe , leje ndertimi, leje shfrytezimi dhe jane ushtruar kontrolle ne te gjitha objektet qe jane ne ndertim e sipër, sipas fazave te ndertimit.

- Jane organizuar 5 (pese) mbledhje te Keshillit Teknik ne te cilat jane paraqitur 29 kerkesa te subjekteve dhe jane miratuar 14 prej tyre; dhe 3 (tre) mbledhje te KRRT-se, ne te cilat jane paraqitur dhe miratuar shtate Detyra Projektimi dhe 27 kerkesa te ndryshme per ndertues dhe banorë te qytetit.
- Nga sektori i Kadastres Urbane jane pregatite të gjitha planet e rilevimit dhe planimetrit e pronave të Bashkisë dhe jane paraprirë procesit të regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Jane regjistruar 20 pronat e para.
- Jane pergatitur dosjet dhe kryer regjistrimi i 20 pronave te bashkise.
- Te ardhurat nga taksat dhe tatimet, planifikuar **70.000.000leke**, realizuar **50.011.436** leke ose **71,4 %**.

Nr.	VITI	Te ardhura		
		Plan	Fakt	%
1	2009	70.000.000	50.011.436	71,4 %

Evidentojme se : Duke u nisur nga tradita e viteve me pare ne realizmin e te ardhurave nga lejet e ndertimit, per vitin 2009 kemi planifikuar te ardhura mbi mundesine reale te ndertimit apo interesave te vete ndertuesve. Kjo eshte edhe aresya e vetme e mosrealizimit te te ardhurave ne kete sektor.

DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE & PERKUJDESIT SHOQEROR

Ka patur si objektiva kryesor :

1. Përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të ndihmes e perkujdesit social ndaj qytetarëve;
2. Kontrollin e permuajshem te familjeve qe aplikojne per ndihme ekonomike dhe ate periodik te familjeve qe jane ne skemen e ndihmes,
3. Hartimin dhe miratimin e 1-2 projekteve për pune e sherbime ne komunitet, me pjesmarrjen e disa familjeve qe jane në skemën e ndihmës ekonomike.
4. Vemendje e posaçme tu kushtohet personave me aftësi të kufizuara, dhe të synohet në përsosjen e shërbimit dhe thithjen e një numri më të madh në qendren e zhvillimit ditor.
5. Të realizohet nje përmirësim i dukshëm ne Qendren e Trajtimit të Moshës së Tretë brënda muajit qershor 2009 etj.

Realizimet sipas sektoreve :

a. Sektori i Ndhimes Ekonomike :

- Vitin e kaluar ka trajtuar me ndihme ekonomike **551 familje**, nga te cilat me ndihme të plotë **436 familje** dhe ndihme të pjeseshme **115 familje**.
- Jane trajtuar në mënyrë të diferencuar **65 familje** të varfëra dhe me probleme specifike si gra të divorcuara, të ve-a, familje me shumë fëmijë, me jetim etj.
- Është punuar për evidentimin e gjendjes sociale te familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të cilët përfitojnë ose jo ndihmë ekonomike.

- Jane evidentuar **1 277 persona** sipas grup moshave, te perfshire ne skemën e ndihmës ekonomike, si kontigjent i parë, per implementimin e projektit, për punë dhe shërbime në komunitet.
- Ne muajin tetor u zbatu projekti me 75 persona me rreth 190 ditë pune, per pastrimin e një siperfaqeje prej 17.000 m² dhe 160 m³ inerte.
- Per aresye ligjore janë larguar nga skema e ndihmes ekonomike 105 familje.

b. Sektori Perkujdesjes Shoqerore :

- Ka rritur nivelin e bashkëpunimit me institucionet e prore dhe ato homologe.
- Janë evidentuar problemet qe kane persona te paafte dhe invalid si dhe eshte asistuar per zgjidhjen e tyre.
- Jane hartuar rregullisht grafiket e rikomisjonimit te dosjeve, per personat e paafte, invalid, te verberit etj., duke bërë te mundur dhenjen e pagave dhe diferencat sipas niveleve.

Te dhenat e vitit - 2009 :

Nr.	Emertimi	Gjithsej	Verejtje
1	Te paafte	307	
2	Kujdestare per te paafte (gjithsej)	92	
3	Invalid gjithesejt	370	
	TOTALI	769	

Krahasuar me vitin 2008 kemi :

1. Te paafte 4 persona me pak
2. Paraplegjike 6 persona me shume.
3. Invalid pune 25 persona me shume.

c. Sherbimet Shoqerore :

- Ne bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe atë Spanjoll eshte realizuar faza e parë të kursit të rrobaqepësisë për 30 vajza dhe gra, nga i cili perfituan 12 veta nga Bashkia Lezhë. Vazhdon faza e dytë e tij.
- Në bashkëpunim me Karitasin Shqiptar, janë shpërndare pako me ushqime për 30 familje të varfëra.
- Eshte realizuar studimi, për treguesit e gjendjes social - ekonomike të familjeve qe kane femije ne kopshtet e qytetit.
- Eshte zbatuar projekti i perkujdesjes ndaj shoqates se te Verbërve.
- Në bashkëfinancim me Korpusin e Paqes ne qershor eshte realizuar kampi veror në fshatin Gjinar të Elbasanit me 35 fëmijë nga familjet ne nevojë.
- Jane zhvilluar disa takime me prindërit e femijeve te Qendrës së Zhvillimit Ditor “ Trëndafilat”, për të trajtuar progresin dhe problemet që ata kanë.

Mbetet objekt i vitit 2010 qe sektori i Ndhimes Ekonomike dhe Perkujdesjes Shoqerore te jete sa me efektiv e gjithnjë afer familjeve dhe personave ne nevojë.

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE:

Ka patur si objektiva kryesore :

1. Kthimin e sektorit te shërbimeve ne një sektor te rëndësishëm në Bashki, per mirëmbajtjen e institucioneve te qytetit, infrastrukturen publike dhe rrjetin rrugor.
2. Te studiohet mundësia e rritjes se kapaciteteve të këtij sektori, duke synuar rritjen e rentabilitetit të tij.
3. Përgatitjen e një studimi te plotë mbi disiplinimin e qarkullimit të automjeteve në territorin e qytetit.
4. Inspektoriat i shërbimit veterinar të inspektojë kushtet e tregëtimit te produkteve me origjinë shtazore dhe ato të peshkut për parandalimin e sëmundjeve apo intoksinimeve.
5. Evidentimin e familjeve qytetase që mbarështojnë kafshë, kushtet e trajtimit dhe masat për heqjen e tyre dhe eliminimin e rreziqeve që rrjedhin nga mbajtja e tyre.
6. Me program pune të posaçem, në bashkërendim me sipërmarrjen, të punohet per implementimin e suksesëshem të projektit të grumbullimit e trajtimit të diferencuar të mbetjeve urbane.

Relizimet :

I. Sherbimet nga sipermarrjet :

a. Pastrimi :

- Realizohet me sipermarrje private ne 75 pika grumbullimi, nga te cilat :
 - 14 pika, ne qender te qytetit zbatohet projekti i Ri i menaxhimit te diferencuar te mbejtjeve urbane ;
 - 61 pika te tjera ndodhen 100 kontainer te zakonshem plastic dhe metalik.
- Niveli i pastrimit ka qene i mire, kjo e shprehur edhe nga banoret nepermes opinioneve dhe anketimeve te bëra ne muajin korrik - gusht 2009.
- Raportet dhe maredhenjet e drejtorise sherbimeve me sipermarrjen e pastrimit kane qene normale, faktor i cili ka ndikuar ne mbarëvajtjen dhe cilësinë e punës.

b. Gjelberimi :

- Edhe ky sherbim realizohet nepermes sipermarrjes private, e cila mbulon nje siperfaqe sherbimi prej 12.970 m2 zona te gjelberura dhe tapete bari.
- Ne kete sektor eshte rritur niveli dhe cilesia e sherbimit, me mbjelljen drureve te rinj dekorativ si; Bliri, Palma, Kumbulla, Meshtegna etj.
- Jane krijuar siperfaqe gjelberimi shtese ne lagje Beslidhja, Skenderbeg, Gurra etj. duke i kthyer ato ne mjedise publike ne sherbim te komunitetit.
- Eshte punuar per inventarizimin e bimesise dekorative dhe zevendesimin e bimeve te demtuara, per te ruajtur performancen dekorative te mjediseve te gjelberuara.

a. Sherbimi i Varrimit dhe Dekori :

- Edhe keto dy sherbime realizohen nepermes sipermarrjes private.

- Jane zbatuar te gjitha kerkesat e shprehura ne kontrate, duke reflektuar edhe ndryshime cilesore vecanerisht ne dekorin e fundvitit.

b. Sherbimi i Transportit dhe Emergjencave Civile:

- Aktualisht ne qytetin e Lezhes kemi rreth 81.000 m² rruge dhe blloqe banimi te asfaltuara , 4.800 m² sheshe dhe 36.400 m² trotuare
- Eshte kompletuar e mirëmbajtur sinjalistika horizontale dhe vertikale ne te gjitha rruget e qytetit, sipas Studimit te Viabilitetit dhe senseve te levizjeve te miratuara.
- Jane vendosur tabelat e duhura, per plotesimin e sinjalistikes vertikale.
- Per shmangjen e levizjeve te shpejta qe nga muaj korrik jane vendosur kurrize te gomuara ne rruget me problematike te qytetit.
- Jane percaktuar venqendimet per automjetet e transportit te udhetareve ne linje apo atyre me taksi, duke i plotesuar me sinjalistiken perkatese.
- Jane plotesuar kerkesat e banoreve te qytetit, per linjen e autobusit Lezhe – Tirane dhe Lezhe-Shkoder te cilat mbulojne te gjitha oraret e kerkuara.
- Eshte punuar me program vjetor te Emergjencave Civile dhe jemi pergjigjur menjehere te gjitha rasteve emergjente te cilat jane bere prezent nga banoret e qytetit, per te cilet eshte paraqitur materiali vlerësues ne Keshillin e Bashkise.
- Eshte avantazh te themi se punimet e kryera ne lumin Drin, kane shmangur permytjet e pervitëshme ne lagje Skenderbeg dhe Beslidhja.

c. Sektori i Strehimit :

- Eshte hartuar Programi 10 vjeçar i Strehimit dhe eshte miratuar ne Keshillin e Bashkise.
- Jane evidentuar te gjitha kerkesat e banoreve te pastrehe, per 278 aplikant.
- Jane miratuar kriteret e klasifikimit sipas stutuset te çdo aplikanti.
- Eshte ngritur dhe ka funksionuar komisioni i strehimit.
- Eshte pergatitur materiali me te gjitha kerkseat me klasifikimet perkatese, per t'u paraqitur per miratim ne Keshillin e Bashkise.
- Ky sektor eshte duke permbushur fazen e dyte te programimit, ate te plotesimit te dosjeve, per te klasifikuar familjet qe perfitojne kredi nga mareveshja e Qeverise me banken e perzgjedhur, per subvencionin e interesave te kredise.

f. Sektori i Sherbimit Veterinar :

Ka synuar :

- Ne kontrollin e perditshem veterinar, per kafshet para therjes dhe kryerjes se ekspertizes se mishit qe del ne treg.
- Kontrollin e vazhdueshme te produkteve blegtorale si mishi, nenproduktet e qumeshtit, vezet etj.
- Kontrollin e perditshem ne lokalet e tregtimit te peshkut.
- Kontrollin periodik te mjeteve te transportit te mishit.

- Realizimin e të ardhurave , nepermes tarifave fiskale të miratura në buxhetin e vitit 2009 etj.

Rezultati :

- Vleresimi i kësaj detyre ka patur si rezultante, gjendjen normale të tregut dhe shmangjen e çdo rreziku në shëndetin e banoreve, nga konsumi i produkteve blegtorale.

Problemet e evidentuara :

- Ndonese janë shenuar permiresime në shërbimin e pastrimit, akoma kemi zona të veçanta kryesisht në periferi të qytetit (L. “Nene Tereza”, ish SMT, ish Xhenjo; ish Nd. Ushqimore) të cilat, janë në nivelin e objektivave të tone, pavaresisht se kjo gjendje krijohet nga vetë banoret, të cilët me inertet e ndertimit dhe mbeturinat shtazore, janë bërë shqetësim për atë komunitet.
- Megjithatë masat promovionale që u morën e vijojnë të perseriten, në drejtim të implementimit të projektit të Ri, për mbledhjen e diferencuar të mbeturinave, akoma nuk është krijuar tradita e ndarjes së mbeturinave nga vetë qytetaret.
- Nuk janë të pakta rastet kur hapësirat publike dhe zonat e gjelberuara “pushtohen” nga subjekte private, të cilët bëjnë mjaft pengesë, për levizjen e lirë të banoreve dhe kryerjen e shërbimit në zonën e gjelberuar.
- Ka dëmtime të perditeshme në konteineret e pastrimit.
- Ka dëmtime në bimesinë dekorative, nga banorë dhe kafshet që mbareshtojnë disa qytetar.
- Ndertimet e reja dhe kryesisht rikonstruksionet e kateve të para, kanë krijuar mjaft probleme në aspektin mjedisor dhe infrastrukturen përreth.
- Për mungesë investimi, nuk realizohet vadija e mjediseve të gjelberuara, pasojë këto të dukshme, në periudhën e verës.
- Krahas permiresimit të sinjalistikës horizontale, nevojiten edhe 122 tabela të reja, për plotësimin e Studimit të Vijabilitetit.
- Për mungesë terreneve të lira, nuk plotësohen kërkesat e komunitetit, për parkim automjetësh.
- Kemi një amortizim total të akseve kryesore të rrueve të qytetit.
- Për të zgjidhur problemin e parkimit të autoveturave, në qytetin të tone me hapësirë të kufizuara, nevojiten projekte që mundësojnë shfrytëzimin e terrenit, për parkingje të reja si; tek ish magazinat e hekurudhës, tunel në malin e Shëngjinit, apo variante të tjeter mbi ujrat e lumit Drin.

DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :

Ka patur si objektiva :

1. Asnjë material që paraqitet për vendimmarrje në këshill apo tek titullari nga administrate të mos kalojë pa patur konfirmimin për bazueshmëri ligjore nga ana e Drejtorisë Juridike.
2. Në bashkëpunim me drejtorinë e financës, të urbanistikës dhe sektorët e tjere, të saktësohet pozicioni juridik i të gjitha pronave bashkiake dhe të hapen procedurat ligjore për vjeljen e detyrimeve nga debitorë të ndryshëm.
3. Të përmirësohen puna për hartimin e dokumentacionit, për publikimin dhe prokurimet publike në përputhje me ndryshimet e legjislacionit.

Relizimet :

a. Në sektorin Juridik :

- Jane ndjekur me kompetence juridike të gjitha proceset gjyqësore ku bashkia ka qene pale e paditur ose e interesuar.
- Jane ndjekur përgatitjet për dokumentacionin ligjor të Parkut Industrial, takimet zyrtare në të gjitha nivelet, deri në miratimin e tij në Këshillin e Ministrave.
- Eshtë punuar në bashkëpunim me ISAID dhe Co Plan, për studimin e Fizibilitetit të Parkut Industrial.
- Eshtë përgatitur dokumentacioni dhe miratuar procedura e privatizimit të 20 banesave, të mbetura pa rregjistruar, të privatizuara pas vitit '94.
- Jane asistuar të gjitha mbledhjet e keshillit bashkise, sipas detyres dhe kërkesës së keshillit.
- Jane ndjekur me përgjegjësi juridike materialet e trajtuara në Këshillin Teknik dhe KRRR-ne të bashkise.
- Eshtë dhënë konsulencë juridike të gjitha drejtorive (kur ajo është kërkuar), si për njohjen e legjislacionit dhe interpretimin e ligjit për rastet konkrete.

d. Sektori i Prokurimeve Publike ka realizuar :

- Shpalljen dhe prokurimin e shtatë tenderave ndër të cilët evidentojmë :
 - 1) Rikonstruksion sheshi lagja Beselidhja,
 - 2) Sistemim dhe asfaltim i rrugës Kodermarlekaj - “Nene Tereza” ,
 - 3) Sistemim dhe asfaltim rrugë blloku “Liria” lagje “Skenderbeg”.
 - 4) Blerje artikuj ushqimor për vitin 2009”
 - 5) Blerje karburanti për Bashkinë.
 - 6) Ndertimi i shkollës 9 vjeçare “Beselidhja”, me fonde të Bankës Botërore ;
 - 7) Ndertim trotuari lagje Beselidhja (tek kompleksi Dashi)
 - 8) Jane tenderuar këto fillim viti edhe dy objekte të tjera si :
 - Rikonstruksion i rrugës para shkollës “Gjergj Fishta”,
 - Rikonstruksion i kanalit të ujrave të bardha në lagjen “Varosh” .

DREJTORIA E PROGRAMIM ZHVILLIMIT :

Synimet :

1. Ndjekja e zbatimit gjithvjetor te elementeve te Strategjise se Zhvillimit.
2. Hartimi i projekteve te zhvillimit, te planifikuara per vitin 2009.
3. Hartimi i Indikatoreve te Zhvillimit te Qytetit, per hartimin e Strategjise se Zhvillimit te Turizmit.
4. Azhornimin e faqes se Internetit te Bashkise.
5. Informimi i publikut, mbi aktivitetin e bashkise, nepermes rinovimit te vazhdueshem te Webseitit te Bashkise dhe botimeve periodike.

Relizimet :

Separi : Eshte realizuar monitorimi i Strategjia e Zhvillimit te qytetit;

Per kete :

- a. Jane evidentuar projektet e realizuara,
- b. Jane zhvilluar konsulenca me sektoret realizues.
- c. Eshte marre pjese ne disa workshope te zhvilluara nen drejtimin e FLAG ne kuader te Delta 2.
- d. Jane zhvilluar disa takime dhe ballafaqime me bashkite simotra, pjesemarrrese ne kete projekt.
- e. Ne zbatim te kerkesave te shtruara eshte hartuar kalendari i veprimtarive dhe plotesimi i dhenave.
- f. Po rishihen matricat e projekteve.
- g. Po pergatitet analiza e zbatimit te strategjise se zhvillimit,
- h. Po punohet per grumbullimin e te dhenave statistikore, per hartimin e Strategjise se Zhvillimit te Turizmit.
- i. Nepermes Projektit te BE, po synohet ne kapjen e projekteve ne kuadrin e IPA-s, per sektoret me evident te qytetit.

Se dyti : Eshte mundesur pjesmarrja ne Panairin Kombetar te Bashkive ne Tirane, ne te cilin bashkia Lezhe pati nje prezantim dinjitoz.

Se treti : Per komunikimin me qytetar eshte realizuar, pergatitjea e botimeve te ndryshme ne aparat, nder te cila evidentojme ;

- a. Pergatitjen dhe botimin e dy buletineve informative dhe jemi ne pergatitje per buletinin e trete.
 - b. Jane hartuar disa flete palosje te thjeshta te cilat, kane patur efekte prezantuese, per arrijet nga zyra dhe sektor te ndryshem ne bashki.

Se katerti : a. Eshte ndjekur programi vjetor i investimeve publike me financime buxhetore dhe nga te ardhurat e bashkise.

- b. Nga specialisti i drejtorise, eshte punuar per pergatitjen e projekteve te zhvillimit dhe dokumentacionin per tenderimet e vitit 2009.

Problemet e evidentuara :

1. Drejtoria e Programim Zhvillimit, ka akoma nje staf te ri, pa pervoje.

2. Nga drejtorite homologe ne bashki, nuk vleresohet ne nivelin e duhur bashkepunimi dhe informimi ne kohe, per te mundesuar plotesimin e te dhenave dhe pergatitjen e materialeve per botim.

DREJTORIA E ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURES & SPORTEVE

Ka patur si objektiv :

- Me një program të posaçëm të punohet për evidentimin dhe stimulimin e talenteve të reja në shkollat 9-vjecare e të mesme.
- Të evidentohet gjendja e shkollave dhe nevojat për nderhyrje ne meremetime, riparime dhe paisjen e tyre gjatë periudhës së verës nëpërmjet sektorit të shërbimeve prane bashkisë.
- Të evidentohen e propogandohen vlerat historike e arkeologjike të zbuluara në qytetin tonë në dinamikën e tyre, duke synuar përgatitjen e një guidë të plotë turistike.
- Të bëhet përgatitja e gjithanshme për të pritur një fluks të rritur turistësh sidomos gjatë stinës së verës.
- Të punohet për rritjen e fondit të librave në biblioteken e qytetit dhe përmirësimin e kushteve të shërbimit e shfrytëzimit të tij.

Niveli i realizimit :

1. Jane evidentuar dhe stimuluar talentet e reja ne arsim, nepermes konkurseve dhe ekspozitave te organizuara ne art, muzike dhe sport.
2. Eshte mundesuar evidentimi i nevojave per riparime dhe rikonstruksione te objekteve shkollore. Janë bërë nderhyrjet me te d.m.d dhe po punohet per projektet e rikonstruksionit te tyre.
3. Ka vijuar puna per evidentimin e vlerave historike dhe kane vijuar puna ne ekspeditat arkeologjike “Lezha 2009” dhe ne “Qafen e Kalase”.
4. Eshte punuar per hartimin e “Masterplanit te Turizimit”, per qytetin tone.
5. Jane promovuar vlërat kulturore te qytetit ne “Panairin Kombetar te Turizmit” dhe eshte shtuar numri i vizitoreve vendas dhe te huaj.
6. **Pallati i Kultures** : ka zhvilluar 18 aktivitete me drejtim tematik, festiv, koncertale dhe spektakle, me artist lezhjan dhe te ftuar.
7. Ne sektorin e **Bibliotekes**:
 - a. Jane realizuar 37 veprimtari ne te cilen kane marre pjese 1480 intelektual, krijues dhe qytetar.
 - b. Fondi i librit eshte shtuar me 794 ekzemplarë.
8. **Klubi Sportiv** : ka zhvilluar nje sere aktivitetetesh te nivelit kombetar dhe lokal. Vlen te theksohet niveli i mire i sportit te mundjes, fitues i kupes se vitit 2009.

Problemet e evidentuar:

1. Nje pune me e kujdeseshme duhet te behet me talentet e reja, per faktin se ata jane te pranishen ne te gjitha aspektet e jetes kulturore, artistike, te dijes dhe

- shkences. Nisma e ketij viti per stimulimin e nxeneseve te shkelqyer duhet zbatuar edhe per talentet e artit, kultures dhe sportit.
2. Amortizimi i godinave dhe paisjeve ne shkollat 9 vjeçare kerkon vemendje te veçante, per gjetjen e burimeve te financimit, per te patur kushte normale per mesim.
 3. Nje vlerësim me te madh ne aspektin e buxhetimit kerkon sektori i kultures, per te mbeshtetur cilesisht aktivitetet qe planifikohen.
 4. Gjendja fizike e Pallatit te Kultures eshte larg misionit te tij.
 5. Biblioteka e ka te nevojshme paisjen me kompjutera te reja dhe sherbimin e internetit, per abonent te moshave te ndryshme qe frekuentojne kete institucion.
 6. Klubi Sportiv, me gjithë perpjekjet e bëra nga specialistet, nuk eshte arritur cilesia sportive e deshiruar, ne menyre te veçante ne futboll.
 7. Gjendja aktuale e infrastruktures sportive dhe baza materiale stervitore, le mjaft per te deshiruar.

DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:

Ka patur si objektiv :

1. Rritjen e efikasitetit e të kontrollit në punë të administratës e sektorëve vartës;
2. Përmirësimin e rritjen e vazhdueshme të nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve;

Synimet :

- Rritja e performances dhe përmirësimi i standarteve ne maredhenje me komunitetin, kultura e komunikimit dhe shpejtesia ne zgjidhjen e kerkesave dhe ankesave te tyre.
- Pasioni, ndershmeria, profesionalizmi dhe përgjegjshmëria ne kryerjen e detyres funksionale nga secili punonjës dhe rritja e besueshmerise se komunitetit ndaj lidershit.

Realizime te përgjithshme :

1. Eshte punuar per plotesimi dhe sistemimi i dosjeve te personelit dhe libri themeltar i punonjësve, me ndryshimet e ndodhura ne vite.
7. Jane reflektuar te gjitha ndryshimet e ndodhura dhe masat e dhena ne emrimet dhe levizjet e personelit te adminitrates.
8. Jane organizuar disa sondazhe ne adminisrtaten e bashkise, per disiplinen dhe efikasitetin ne pune.
9. Jane vene nen kontroll dhe reduktuar maksimalisht shpenzimet administrative.
10. Eshte punuar per krijimin e kushteve te punes se punonjesve, si per mjediset dhe logjistiken e punes.
11. Nga sektori i protokollit jane menazhuar shkresa te hyra (1335 cope), te dala (1416 cope), 60 urdhera, 29 vendime dhe 147 akte per bllokim aktiviteti, ne funksion te detyres se administrates.

12. Jane organizuar pritje ditore dhe periodike, per problemet te ndryshme si per strehim, punesim, ndihme ekonomike, sherbime publike etj.

Gjithsej	Lloji i kerkeses :						
	Punesim	Strehim	Nd. Financ.	Akt. tregetar	Per privatiz.	Sherb. Publik	Te tjera
1 266	376	52	334	106	39	229	130
%	29,6	4,1	26,4	8,3	3	18	10,3

13. Jane pritur e dhene pergjigje rreth 3.670 persona (qytetar), disa prej te cileve me shume se nje here, mesatarisht 306 veta / muaj, ose rreth 14 veta / dite.

14. Eshte synuar ne dhenjen e asistences direkte ndaj qytetareve te paraqitur ne bashki dhe angazhimin e personelit ne zgjidhjen e shpejte te problemeve.

15. Jane dhene 175 kronika televizive ne televizionin publik shqiptare, pa llogaritur qindra kronika, intervista dhe komente te ndryshme ne median lokale etj.

16. Eshte hartuar Kodi Etikes dhe vene ne administrim te te gjitha punonjesve.

Si mosrealizime evidentojme :

- Akoma nuk eshte vene ne zbatim monitorimi elektronik i punes se administrates.
- Akoma nuk jane stabilizuar te gjitha drejtorite me zyra pune, per mungese mjedisesesh.
- Nuk eshte sistemuar nje pjese e arkivit para viteve 2007 transferuar tek Biblioteka e qytetit.
- Nuk eshte punuar per informatizimin e materialit arkivor.

Mangesite te konstatuara :

- Nga kontrollet e ushtruara per disiplinen formale te punes rezulton te kete mungese korektesie, ne paraqitjen dhe levizjet jashte zyrave
- Nga monitorimi ditor i punes nuk rezulton shfrytezim racioanal i kohes dhe efikasitet maksimal ne pune.
- Tendencat per vetekualifikim dhe vetemonitorim te kohes se punes jane larg te qenurit pasion dhe detyrim profesional, nga disa punonjes, ne menyre te veçante nepunesit e rinj.
- Pergjegjshmeria ne kryerjen e detyres dhe koordinimi ndermjet zyrave dhe specialisteve, per krijimin e nje fronti unik ne zgjidhjen e ankesave dhe kerkesave te qytetareve, jo gjithnje ka efikasitetin e duhur.

ZYRA E GJENDJES CIVILE:

Nder objektivat kryesore evidentojme :

- Persosjen e metejsme te sherbimit ndaj qytetareve.
- Perballimin e te gjitha fazave para zgjedhore, hartimin, shpalljen dhe permiresimin e listave zgjedhore.
- Koordinimin e punes me njesine e prodhimit te Kartave te identitetit dhe pasaportave Biometrike.

Arritjet e vitit :

- Përmirësimi i sherbimit ndaj qytetareve.
- Pergatitja e Rregjistrit Kombetar te zgjedhjeve dhe perballimi ne afate ligjore te gjitha fazat parazgjedhore.
- Krijimin e kushteve te punes dhe implemtimi i projektit, per leternjoftimet e reja dhe pasaportat Biometrike.
- Nder ndryshimet demografike evidentojme :
-

Popullsia/banor	meshkuj	femtra	shtesa/2009
27.726	13.600	14.126	+ 641
Ndryshimet	lindje	martesa	vdekje
	209	160	101

INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

Objektivat e vitit 2009:

- Venja nen kontroll te plote te territorit urban te Bashkise.
- Zbatimi i ligjshmerise nga subjektet qe ndertojne ne qytet.
- Nderhyrja ne prishjen e objekteve pa leje.

Rezultati :

- ❖ Kontrolli i zbatimit te ligjshmerise ne te gjitha objektet e paisura me leje ndertimi nga KRRT-ja e Bashkise.
- ❖ Evidentimi i objekteve te ndertuara pa leje ne territorin e Bashkise.
- ❖ Bllokimi i punimeve ne objetet qe ndertohen pa leje dhe masa administrative (gjoba) ndaj subjekteve ndertuese qe nuk zbatojne kerkesat ligjore.
- ❖ Nderhyrja per prishjen e 76 objekteve ndertuar pa leje ne blloqet e banimit, per krijimin e kushteve per investime te reja.

Probleme te evidentuara :

- Jane me dhjetera banesa te ndertuara ne zonen arkeologjike dhe me rrezik rreshqitje.
- Akoma mbijeton mentaliteti i ndertimit pa leje, ndonese kostoja e demeve qe vjen nga prishjet e objekteve eshte mjaft serioze, per ekonomine e qytetarit.

- Ngritja e kateve pa leje gjate ndertimit te pallateve vijon te mbetet prezent si mentalitet antiligjor.

Keto ishin disa nga realizimet e vitit 2009 nga çdo sektor dhe administratat ne teresi dhe mangesite e konstatuara te cilat u bëne prezent.

Rekomandime :

1. Krijimi i nje vizioni te qarte per vitin 2010 tek çdo punonjes, sektor apo administrata ne terese, per nje perceptim te qarte se na pret nje pune mjaft serioze, per mbylljen e nje mandati qeverises.
2. Rishikimi i gjithe objektivave te marra ne vitin 2007 para komunitetit lezhjan dhe percaktimi i rrugeve per implementimin e plote te tyre.

Duke Ju falenderuar për vemendjen.

KRYETARI I BASHKISE

VIKTOR TUSHAJ

Lezbe, me15.01.2010